

## Përsëritje dhe ushtrime e kapitullit 6

D1. Të njehsohet syprina e paralelogramit nëse është dhënë:

a)  $a=12\text{cm}$ ,  $h_a=8\text{cm}$

b)  $a=20.5\text{cm}$   $h_a=15.4\text{cm}$

c)  $a=6.2$   $h_a=4.5$

Ndihmë: Syprina e paralelogramit llogaritet me formulën  $S= a \cdot h_a$  ose  $S= b \cdot h_b$

D2. Të llogaritet syprina e trekëndëshit këndëdrejtë nëse hipotenuza është 13 cm ndërsa njëra katete është 5 cm.

Ndihmë: Syprina e trekëndëshit këndëdrejtë llogaritet me formulën  $S = \frac{1}{2} a \cdot b$

D3. Të llogaritet syprina e trekëndëshit nëse janë të dhëna:

a)  $a=11\text{cm}$ ,  $b=10\text{cm}$ ,  $\gamma = 150^\circ$

b)  $a=8\text{cm}$ ,  $c=10\text{cm}$ ,  $\gamma = 75^\circ$

Ndihmë: Njëra ndër formulat për të llogaritur syprina e trekëndëshit është  $S = \frac{1}{2} a \cdot b \cdot \sin \gamma$

D4. Të llogaritet syprina dhe perimetri i rrethit me  $r=4$ .

Ndihmë: Perimetri e rrethit llogaritet me formulën  $S = 2 r \pi$  dhe syprina e rrethit llogaritet me formulën  $S = r^2 \pi$

D5. Të llogaritet gjatësia e harkut rrethor nëse e kemi të dhënë rrezen  $r=15\text{cm}$  dhe këndin

a)  $60^\circ$

b)  $30^\circ$

Ndihmë: Formula për të llogaritur gjatësinë e harkut rrethor është  $l = \frac{r \pi \alpha}{180}$

Detyrat e zgjedhura i dërgoni në email [lirie\\_memeti@hotmail.com](mailto:lirie_memeti@hotmail.com)

Për çdo paqartësi mos hezitoni të më shkruani.